



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha**

Elbasan, më: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**  
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**  
**“Blerje materiale mekanike për nevojat e shoqërisë”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP: 24951000-5 graso dhe lubrifikante, 44440000-6 kushineta.

**FONDI LIMIT: 5,990,100** (pese milion e nenteqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind) Lekë **pa TVSH**

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rajoni Elbasan” sha**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Ofertuesi për t’u kualifikuar duhet të ketë në objektin e veprimtarisë së tij në shërbimin e kërkuar nga ana jonë: **“Blerje materiale mekanike për nevojat e shoqërisë”**, dhe në përputhje me specifikimet teknike

**Preventiv: “Blerje materiale mekanike për nevojat e shoqërisë”**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i artikujve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Vaj SA E 5 - 40W	litra	150
2	Vaj SA E 10-40W	litra	150

3	Vaj SA E 20 - 50 W	litra	100
4	Grasso kundra uje e temperature -20:+180	kg	100
5	Bullona xhuntoje pome DK 400	cope	50
6	Xhunto pompe gize DN 400	cift	2
7	Xhunto pompe gize 2K6	cift	2
8	Xhunto pompe gize 3K6	cift	1
9	Dado shtrengues te kushinteve DK 400	cope	10
10	Unaze gize per suportet	cope	8
11	Kundralvula me sfere DN 200 /PN 25 pompat gjermane	cope	6
12	Kundralvula DN 400/ PN 40 (Riparim)	cope	2
13	Kompesator DN 200/PN 25	cope	3
14	Kundralvula DN 300 / PN 40 (Riparim)	cope	2
15	Bokulla gize per unazat e vajit	cope	10
16	Bokulla litari DN 400 Gize	cope	10
17	Bokulla bronxi saracineske DN 400	cope	10
18	Bokulla saracineske DN 300 (bronsi)	cope	10
19	Bokulla saracineske 200 (bronsi)	cope	10
20	Bokulla saracineske 100 (bronsi)	cope	10
21	Bokulla bronxi saracineske 400 me dy fileta	cope	6
22	Bokulla permstopi saracineske DN 400	cope	16
23	Karton preshpan (2x1.5)	tabak	16
24	Karton amjanti 4 mm (4x1.5)	kg	30
25	Karton amjanti 2 mm (2x1.5)	kg	10
26	Litar permstopi Ø 16	kg	80
27	Litar permstopi Ø 12	kg	60
28	Litar permstopi Ø 14	kg	40
29	Litar permstopi Ø 6	kg	50
30	Litar permstopi Ø 8	kg	50
31	Litar permstopi Ø 18	kg	100

32	Kushinete pompe 6302	cope	12
33	Kushinete motorri 6308	cope	15
34	Kushinete motorri 6309	cope	15
35	Kushinete motorri NJ 322	cope	2
36	Kushinete motorri 6322	cope	2
37	Kushineta motorri pompe 2k6 6310	cope	15
38	Kushineta motorri pompe 2k6 6306	cope	15
39	Kushinete pompe 6307	cope	15
40	Kushinete pompe 2k6 6206	cope	15
41	Kushinete pompe 6208	cope	15
42	Kuzhinieta motorri 6319	cope	10
43	Kushinete motorri 6314	cope	10
44	Kushinete motorri 6312	cope	10
45	Kuzhinieta pompe 409	cope	7
46	Kuzhinieta pompe 2316	cope	10
47	Kuzhinieta pompe 6316	cope	15
48	Kuzhinieta 2409	cope	10
49	Kuzhinieta per pompat 7322	cope	5
50	Kuzhinieta per pompat 6028	cope	10
51	Kushinieta pompe 6313	cope	2
52	Shkarkus ventil 6-10kv	cope	6
53	Ventiluese tip per pompat vertikale	cope	10
54	Valvul presioni per pompat e klorit	cope	8
55	Kambeta te ndryshme	cope	13

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

**Argumentimi:** Ky kriter është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 82 “Formulari i vetëdeklarimit”, dhe në nenin 83, “Sigurimi i ofertës”, si dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 dhe neni 30.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë QKB me veprimtari objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 pika 1, ku shprehimisht thuhet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”, si dhe në VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 5/a: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*”.

**2.1.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për pagimin e taksave dhe tatimeve ,të kontributeve të sigurimeve shoqërore, të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr. 9632 datë 30.10. 2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiakë të njëjësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime).*

**Argumentimi:** Ky kriter është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26, pika 2: “*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së.*”

**2.1.3** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime).*

**Argumentimi:** Ky kriter mbështetet në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 14, pikat 2 dhe 3, si dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të procedurës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Ky kriter është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1, “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*, dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) për 3 vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të procedurës të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo

kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Ky kriter është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40, pika 4: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të

*madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për përmbushjen e Specifikimeve Teknike.  
**Argumentimi:** Ky kriter është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2: “Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.” dhe, në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 2: “Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e mallit të kërkuar në objektin e DST pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve, sasisë dhe specifikimeve të përcaktuara sipas Tabelës së Shtojcës 6.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet transportit me mjetet dhe shpenzimet e tyre, sipas grafikut të lëvrimin të vendosur nga autoriteti kontraktor.

**2.3.4** Ditën dhe orën e hapjes së Ofertave subjekti Ofertues të paraqesë nga një mostër për të gjithë produktet të cilat duhet të jenë me mbyllje fabrike dhe etiketë fabrike jo etiketë të bërë nga subjekti Ofertues. Në etiketë të jenë të shënuara të gjithë specifikimet teknike të produktit sipas Tabelës në Shtojcën 6, të kërkuar nga AK.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021, neni “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6, “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë

dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”. Me anë të kësaj kërkesë, AK do të sigurohet për cilësinë e artikujve objekt i këtij prokurimi, pasi kanë rol të rëndësishëm në funksionimin e pajisjeve ku do të përdoren, dhe për rritjen e jetëgjatësisë së tyre.*

**Shënim:** Mostrat do të paraqiten nga OE, pranë AK ditën e hapjes së ofertave. Mos paraqitja e të gjitha mostrave, apo mospranimi për kryerjen e testeve për artikujt vaj dhe graso, dhe nuk pranon të lëshojë deklarata garancie jo më të vogël se 1 (një) vit për kushinetat , përbën kusht për s’kualifikim!

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes së nënshkruar mes palëve).

**Argumentimi:** Ky kriter është bazuar në Ligjin 162/202 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”. Në këtë kërkesë AK ka parashtruar kërkesa minimale për të mos penalizuar OE që kanë interes të marrin pjesë në këtë procedurë.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**